

Për: Banorët e rrugës Rilindja ‘Prishtina e Re Zona Perendim’

Nga : Drejtoria e Urbanizmit, Komuna e Prishtinës

Subjekti: Përgjigje banorëve të rrugës ‘Rilindja’ në shkresën ‘Ankesa lidhur me kerkesen 05-350
05-350/02-76258/19 dt. 02.04.2019’ për ndërtimin e autolarjes me karakter të përkohshëm

Data: 10.06.2019

1. Kërkesa për Autolarje me karakter të përkohshëm do të shqyrtohet duke u bazuar në ‘Rregulloren për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm për pronat e personave fizikë dhe juridik, Nr. 01. nr. 110-288305, më 31.12.2014’.

2. Në aspektin e komunikacionit dhe për qasje në parcelë, do ta jep mendimin e tij profesional ekspertin e komunikacionit.

3. Pas ankesës nga [<mailto:bordilagjes@gmail.com>] të dt. 07.05.2019, pronari i tokës është lajmëruar në Drejtorinë e Urbanizmit me dt. 16.05.2019 dhe është mbajtur një ‘Procesverbal’ ku deklarohet se i ka takua disa nga fqinjët mirëpo sipas tyre nënshkrimet e dorëzuara me ‘Petition’ janë dhënë për xhami e jo për autolarje. Këtë e dëshmuar edhe tre banorë të lagjes që ishin prezent në Drejtorinë e Urbanizmit (Procesverbali i dt. 23.05.2019 i nënshkruar nga tre banorë të lagjes dhe dy zyrtarë të Drejtorisë së Urbanizmit).